



C1-EU-NPA

CLUSTER ONE EU NEGOTIATIONS PLATFORM – ALBANIA



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

DOKUMENT POLITIKASH

SFIDAT E EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT NË SHQIPËRI

Ky publikim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) është realizuar në kuadër të projektit C1 – EU – NPA, “Përmirësimi i Debatit mbi Politikat dhe Llogaridhënien për të Përbushur të Drejtat Bazike, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster 1 Shqipëri”, zbatuar nga katër organizata shqiptare, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti për Studimet Politike dhe Instituti Shqiptar i Shkencës, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Tiranë.

Mendimet e shprehura në këtë dokument politikash (policy paper) janë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit dhe organizatave zbatuese.

Përgatiti dokumentin: Dr. Jonida Rystemaj, Eksperte Ligjore e jashtme e KShH-së

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt” Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Mob: 0694075732

e-mail: office@ahc.org.al

web site: www.ahc.org.al



C1-EU-NPA

CLUSTER ONE EU NEGOTIATIONS PLATFORM – ALBANIA



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

DOKUMENT POLITIKASH

SFIDAT E EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT NË SHQIPËRI

Përmbajtja

Lista e Shkurtimeve	5
Përmbledhje ekzekutive	6
Metodologjia	8
Hyrje	9
1 Edukimi ligjor i publikut në një perspektivë europiane	11
2 Kuptimi i Edukimit Ligjor të Publikut.....	13
2.1 Format e Edukimit Ligjor të Publikut	14
2.2 Përfituesit dhe qëllimi i ELP.....	15
3. Historiku i lindjes dhe zhvillimit të Edukimit Ligjor të Publikut	16
4. Kuadri i brendshëm rregullues për Edukimin Ligjor të Publikut	17
4.1 Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut.....	17
4.1.1 Struktura Mbikëqyrëse e SELP	18
4.2 Plani i Veprimit	19
5. Roli i institucioneve kryesore në edukimin ligjor të publikut	20
5.1 Kuvendi	20
5.2 Ministria e Drejtësisë	21
5.2.1 Roli i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në Edukimin Ligjor të Publikut	21
5.3 Këshilli i Lartë Gjyqësor	22
6. Roli i Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në drejtim të realizimit të ELP	24
7. Modelet më të mira të zbatimit të suksesshëm të edukimit ligjor të publikut	26
8. Sfidat e Edukimit Ligjor të Publikut në Shqipëri	7
9. Gjetjet dhe Rekomandime	29
Bibliografia	32



Lista e Shkurtimeve

ELP- Edukimi Ligjor i Publikut

SELP-Strategjia e Edukimit Ligjor të Publikut

PV- Plani i Veprimit

DNJF-Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas

Kuvendi- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

KLGJ- Këshilli i Lartë Gjyqësor

MD- Ministria e Drejtësisë

BE- Bashkimi European

SL-Street Law

OSHC-Organizata të Shoqërisë Civile

Rrjeti-Rrjeti Kombëtar i Edukimit Ligjor të Publikut

KDELDP -Komisioni Drejtues i Edukimit Ligjor të Publikut

Bordi Këshillimor-BK

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kuptimi i normave të së drejtës jo vetëm aftëson individin për t'i zbatuar, por njëherësh ndikon në konsolidimin e shtetit të së drejtës pasi ndihmon në krijimin e institucioneve publike më llogaridhënëse që duhet të përgjigjen ndaj qytetarëve më të informuar dhe të ndërgjegjësuar për të drejtat e tyre. Ndaj, në këtë kontekst për njohjen dhe kuptimin e normave që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, është e nevojshme që “leksionet mbi të drejtën të dalin jashtë katedrave të fakulteteve të drejtësisë” dhe t'u drejtohen qytetarëve. Në këtë mënyrë, individët ndërgjegjësohen për të drejtat dhe detyrimet, kuptojnë rëndësinë dhe pasojat e veprimeve të tyre, dhe potencialisht mund të parandalojnë konfliktet gjyqësore.

Njohja e normave ligjore me ndikim në jetën e qytetarëve realizohet përmes programeve të edukimit ligjor të publikut. Në vendin tonë, ELP ka qenë përgjithësisht jashtë vëmendjes shtetërore, deri në hartimin e dokumentit të Analizës së Reformës në Drejtësi, i cili identifikoi nevojën për ELP si një nga drejtimit kryesore për të krijuar kulturën juridike, si dhe për të mundësuar qasjen e qytetarëve ndaj shtetit të së drejtës.¹ Nga ana tjetër, kjo analizë vuri në dukje mungesën e qëndrueshmërisë së ELP pasi ofrimi i tij ishte rastësor, i paplanifikuar dhe i paorganizuar.²

Vlen të theksojmë që vëmendja shtetërore drejt ELP dhe miratimi i akteve kushtuar ekskluzivisht ELP është një hap shumë cilësor drejt hedhjes së themeleve për ofrimin e ELP në vazhdimësi. Deri me miratimin e Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut nuk ka pasur akte me fokus ekskluziv ELP, ndonëse rregullime për të gjenden në mënyrë shumë sporadike në akte të tjera ligjore si për shembull, Kodi i Procedurave Administrative, ligji “Për të drejtën e Informimit”, ligji i ri “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”³ apo edhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. Miratimi i SELP dhe PV përbën një hap të rëndësishëm drejt njohjes dhe progresit të ELP.

Në funksion të arritjes së objektivave strategjike të përcaktuar, SELP ka krijuar edhe një strukturë koordinuese dhe mbikëqyrëse për ELP të organizuar në dy nivele. Niveli i parë përfaqësohet nga mbikëqyrja që ushtron MD si institucioni i përcaktuar për përgatitjen e draft raporteve pasi mbledh raportimet nga institucionet anëtare. Dhe niveli i dytë i mbikëqyrjes është Rrjeti Kombëtar i Edukimit Ligjor të Publikut (Rrjeti), si strukturë që bashkërendon të gjithë institucionet me qëllim ndjekjen e politikës kombëtare për ELP. Rrjeti funksionon përmes organeve të tij që rregullohen nga Rregullorja e Rrjetit.

Ndonëse janë bërë hapa para duke miratuar akte të rëndësishme si SELP dhe PV, nga shqyrtimi i këtyre dokumenteve dhe vlerësimi i zbatimit të tyre në praktikë, rezulton që ELP ndeshet me problematika. Strategjia shoqërohet nga konfuzioni sa i përket kuptimit të ELP pasi dokumenti nuk është mbështetur në një përkufizim të pranuar duke sjellë për rrjedhojë mungesën e identitetit koherent të strategjisë dhe identifikimin e praktikave më të mira në ofrimin e edukimit ligjor të publikut.

1 Dokumenti Analitik i Reformës në Drejtësi, f. 214, e aksesueshme në http://www.reformanedrejtisi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf

2 Ibid., f. 215.

3 I cili parashikon ofrimin e edukimit ligjor të publikut nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas. Për hir të së vërtetës edhe ligji tashmë i shfuqizuar “Për ndihmën juridike” parashikonte edukimin ligjor të publikut si një nga format e ndihmës juridike e cila ofrohej përmes klinikave lëvizëse, publikimeve, fushatave televizive dhe në medien e shkruar, si dhe masa të tjera të ngjashme, duke u kushtuar vëmendje të veçantë problemeve të grupeve më në nevojë. (Neni 11(2) ligji Nr.10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”).



Konfuzioni që shoqëron dokumentin strategjik reflektohet edhe në draft-raportet e monitorimit nga MD që nxisin institucionet publike për saktësi në plotësimin e raportimeve që dërgohen tek MD⁴. Nënvizojmë se mungesa e një përkufizimi konkret për edukimin ligjor të publikut, ka sjellë si rrjedhojë që një pjesë e mirë e aktiviteteve që referojnë institucionet si veprimtari të kryer në kuadër të ELP të mos klasifikohen si të tilla.

Gjithashtu, rezulton se struktura institucionale e krijuar për zbatimin e SELP nuk është shumë e përshtatshme për arritjen e objektivave të synuar. Nisur nga modelet e vendeve më me përvojë në edukimin ligjor të publikut, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo Mbretëria e Bashkuar, kjo veprimtari arrihet më mirë nëse ka mbështetje financiare (e jo vetëm) shtetërore, por duke angazhuar subjektet që kanë një traditë më të konsoliduar në ofrimin e programeve të edukimit ligjor të publikut siç janë Universitetet dhe organizatat e shoqërisë civile. Për këtë arsye, duhet rivlerësuar struktura dhe përfaqësimi i anëtarëve në Rrjet. Ndërkohë që pjesën më të madhe të anëtarëve të Rrjetit duhet ta kishin përfaqësues nga fakultetet e drejtësisë dhe organizata të shoqërisë civile, në fakt, e kanë institucionet publike⁵ të cilat po përballen me sfida në ushtrimin e këtij aktiviteti siç rezulton edhe nga raportimet që kanë kryer pranë MD.

Gjithashtu, nga puna kërkimore e realizuar konstatohet mungesa e programeve të mirëfillta për ofrimin e ELP të përshtatura sipas grupeve të targetuara. Gjejmë me vend të theksojmë se nisja e veprimtarisë së Rrjetit duhet të ishte paraprirë nga studime që të identifikonin nevojën prioritare për ndërhyrje, duke sjellë të dhëna empirike mbi njohuritë e qytetarëve mbi të drejtat e tyre dhe nevojat konkrete që kanë grupe të caktuara. Këto të dhëna do të ndihmonin në identifikimin e mekanizmit që më mirë arrin objektivin e synuar.

Nga analiza e draft-raporteve të hartuara nga MD⁶ në zbatim të detyrimeve të SELP dhe PV, konstatohet se ELP është i fragmentizuar dhe i pakoordinuar. Nuk ka shkëmbim eksperiencash, njohurish apo zhvillim të praktikave më të mira nga anëtarët e Rrjetit për edukim cilësor të publikut. Për rrjedhojë, nevojitet një bashkëpunim më i madh mes aktorëve që ofrojnë ELP.

Për ta përmbyllur, nisur nga gjetjet kryesore të këtij dokumenti, si edhe nga përgjigjet e dërguara nga institucionet që kanë një rol dhe ndikim domethënës në ofrimin e ELP, vlerësojmë se ka një periudhë stanjacioni të zbatimit të Strategjisë për shkak të mungesës së aktivizimit të Rrjetit dhe institucioneve anëtare në përmbushje të detyrimeve që burojnë prej saj.

4 Draft-Raporti i Monitorimit Për Periudhën Janar-Dhjetor 2020, f. 55-56.

5 Në Rrjet rreth 20% e anëtarëve përbëhet nga fakultetet e drejtësisë dhe 80% nga institucionet publike.

6 Shih Draft-Raporti i Monitorimit Për Periudhën Janar-Dhjetor 2020, dhe Draft-Raportin e Monitorimit Për Periudhën Janar-Dhjetor 2021 (<https://www.drejtësia.gov.al/raportet-e-monitorimit-v-shqip/>).

Metodologjia

Ky dokument është hartuar duke kombinuar metodën desk research për të evidentuar kuadrin ligjor, strategjik dhe institucional dhe metodën krahasuese duke përzgjedhur vende më traditë të mirë në edukimin ligjor të publikut. Në fokus të analizës së kuadrin ligjor janë vënë dy aktet kryesore që kanë për objekt rregullimin e ELP, i.e. Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Plani i Veprimit. Duke qenë të parët dokumente që adresojnë edukimin ligjor të publikut, analiza ka pasur një qasje kritike, jo vetëm për zbatimin e tyre, por edhe në konceptim, pasi disa nga problematikat e konstatuara në zbatimin e strategjisë, marrin fill nga problemet që lidhen me konceptimin e saj.

Për informacione që ishte vështirë për t'u gjendur nga faqet zyrtare web të disa institucioneve, u përpiluan kërkesa për informacion. Institucionet e përzgjedhura ishin Kuvendi, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë, si anëtare me një rol më domethënës në Rrjetin Kombëtar të Edukimit Ligjor të Publikut. Të dhënat që rezultojnë nga kuadri rregullues dhe detyrimet që imponojnë këto i janë nënshtruar një analize krahasuese me përgjigjet e kthyer nga institucionet e lartpërmendura.

Dokumenti ka synuar gjithashtu ofrimin e një perspektive krahasuese me standardet dhe praktikën më të mira të ELP. Këtu, janë përzgjedhur dy juridiksione, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretëria e Bashkuar për shkak të zhvillimit të ELP, por edhe për shkak të një kontributi më të madh që studiuesit dhe akademikët kanë dhënë në këto vende për zhvillimin e konceptit teorik të ELP.

Një nga kufizimet me të cilat u përball hartimi i dokumentit të politikave është mungesa e dokumenteve, trajtesave teorike apo artikujve shkencorë kushtuar strukturave të krijuara për edukimin ligjor të publikut nga vende të tjera të rajonit, apo edhe të krahasueshme me Shqipërinë për nga niveli i zhvillimit, ekonomik, social dhe arsimor. Për këtë arsye, ka qenë e vështirë sjellja e modeleve më të mira prej vendeve të rajonit. Prandaj, edhe praktikën më të mira janë përzgjedhur prej dy shteteve të lartpërmendura.

Dokumenti ndjek strukturën vijuese: Seksioni i parë i kushtohet kuptimit të edukimit ligjor të publikut, duke u përpjekur që të sjellë një përkufizim të ELP, duke identifikuar përfituesit dhe format kryesore të realizimit në praktikë të ELP. Në seksionin e dytë një vështrim shumë i shkurtër historik hedh dritë mbi lindjen dhe zhvillimin e ELP në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe përhapjes së tij pak më gjerë. Seksioni i tretë ka në fokus kuadrin rregullues të brendshëm të ELP, kryesisht theksi është vendosur mbi SELP dhe PV. Seksioni i katërt ndalet tek roli i disa prej institucioneve kryesore në drejtim të edukimit ligjor të publikut. Seksioni i pestë identifikon tiparet e dy prej modeleve më të mira në mënyrë që eksperiencat e tyre të shfrytëzohet për të zbatuar modelin më të mirë të ELP në vendin tonë. Në fund, duke u bazuar në gjetjet e analizës pararendëse, dokumenti sjell disa rekomandime për përmirësimin e infrastrukturës institucionale të ELP dhe përshtatjen e një modeli funksional për arritjen e objektivave strategjike të SELP.



Hyrje

Edukimi ligjor i publikut synon krijimin e kulturës juridike përmes njohjes dhe kuptimit të ligjit nga qytetarët. Në të vërtetë, ekziston një prezumim ligjor i njohjes së ligjit, pas botimit të tij në fletoren zyrtare, ku kjo e fundit shërben si një mjet për të përcjellë tek publiku aktet me fuqi detyruese. Megjithatë, në kushtet e një inflacioni legjislativ, përmes shtimit të numrit të akteve të miratuara që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, e veçanërisht në kushtet kur normat rregulluese të marrëdhënieve juridike po bëhen përherë edhe më komplekse dhe të artikuluar me një gjuhë shpesh teknike, vihet në pikëpyetje vërtetësia e këtij prezumimi. Ndaj, në këtë kontekst për njohjen dhe kuptimin e normave që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, është e nevojshme që “leksionet mbi ligjet dhe të drejtën të dalin jashtë katedrave” të fakulteteve të drejtësisë. Kuptimi i normave, veçanërisht atyre me ndikim më të madh në jetën e individit, duhet të dalë jashtë sferës ekskluzive të juristëve. Në këtë mënyrë, individët ndërgjegjësohen për të drejtat dhe detyrimet, kuptojnë rëndësinë dhe pasojat e veprimeve të tyre, dhe potencialisht mund të parandalojnë konfliktet gjyqësore.

Nisur nga ky sfond, edukimi ligjor i publikut mund të shihet si një instrument për fuqizimin e individit përballë palës potencialisht më të fortë dhe shtypëse, që janë institucionet publike. Thënë ndryshe, edukimi ligjor i publikut (ELP) i shërben ‘aftësisimit ligjor/juridik’, koncept i cili i referohet “dijes, aftësive dhe besimit të nevojshëm për të zgjidhur çështjet personale ligjore”.⁷ Sigurisht, ELP nuk mund të zëvendësojë asnjëherë arsimin juridik, i detyrueshëm për të ushtruar profesionin e juristit, por shërben si një instrument për rritjen e njohurive ligjore të publikut, ndër të tjera, edhe për të sfiduar vendimmarrje publike.⁸ Qytetarët më të ndërgjegjësuar për të drejtat e tyre bëhen më kërkuar ndaj autoriteteve publike duke rritur llogaridhënien e tyre.

Autorët që kanë përkufizuar konceptin e shtetit të së drejtës, kanë nxjerrë në pah dy elementë identifikues të tij që janë ‘për sa është e mundur, qartësia, aksesueshmëria dhe praktikiteti’ si dhe ‘krijimi i instrumenteve për zgjidhjen, pa kosto frenuese ose vonesa të panevojshme, konfliktet civile në mirëbesim, të cilat palët nuk mund t’i zgjidhin vet’.⁹ Kuptimi praktik i këtyre dy komponentëve është që ligji duhet të jetë i kuptueshëm për të justifikuar zbatimin e detyrueshëm të tij tek qytetarët dhe që shteti duhet të garantojë aksesin në drejtësi për të korrigjuar veprime të padrejta në dëm të subjekteve.¹⁰ Në këtë kontekst, ligji është më i kuptueshëm për publikun nëse ai shpjegohet me terma të thjeshtë e të qartë për të. Pra, kur koncepte të ndërlikuara ligjore zberthehen në një gjuhë të kuptueshme për një individ jo jurist.

Në vendin tonë, ELP ka qenë përgjithësisht jashtë vëmendjes shtetërore, deri në hartimin e dokumentit të Analizës së Reformës në Drejtësi, i cili identifikoi nevojën për ELP si një nga drejtimet kryesore për të krijuar kulturën juridike si dhe për të mundësuar qasjen e qytetarëve ndaj shtetit të së drejtës.¹¹ Nga ana tjetër kjo analizë vuri në dukje, mungesën e qëndrueshmërisë në drejtim të ofrimit të ELP pasi u konstatua që ELP

7 Abiodun Michael Olatokun, *The Journey to Legal Capability: Challenges for Public Law from Public Legal Education*, f. 28.

8 Ibid. f. 29

9 Tom Bingham, “The Rule of Law” (Penguin 2010) Pp 37, cituar nga Abiodun Michael Olatokun, *The Journey To Legal Capability: Challenges for Public Law from Public Legal Education*, f.30.

10 Abiodun Michael Olatokun, *The Journey to Legal Capability: Challenges for Public Law from Public Legal Education*, f.30.

11 Dokumenti Analitik i Reformës në Drejtësi, f. 214, e aksesueshme në http://www.reformanedrejtisi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf

ishte ofruar në mënyrë rastësore, të paplanifikuara dhe të paorganizuar.¹² Për hir të së vërtetës, organizata të shoqërisë civile, kanë realizuar në mënyrë të vazhdueshme veprimtari të edukimit ligjor të publikut, por kjo nuk është mbështetur edhe nga veprimtari të tjera më të qëndrueshme të realizuara nga institucionet shtetërore.

Ndaj, grupi i punës së ekspertëve të nivelit të lartë të reformës në drejtësi që ishin përgjegjës për reformimin e arsimit të lartë juridik, hodhi idenë për hartimin e strategjisë për edukimin ligjor të publikut si pjesë e reformimit tërësor që pësoi sistemi i drejtësisë, me shpresën që në këtë mënyrë do të institucionalizohet edukimi ligjor i publikut.¹³

Për të jetësuar gjetjet dhe nevojat e identifikuara nga ekspertët e nivelit të lartë të reformës në drejtësi, u hartua Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP) e cila u miratua me vendimin e Kuvendit numër 47/2019, “Për Miratimin Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023”. Ky dokument strategjik shërben si kuadri i parë rregullues kushtuar ekskluzivisht ELP. Njëherësh SELP krijon edhe strukturën e parë mbikëqyrëse të strategjisë e cila ndihmon në arritjen e objektivave të saj. Përpos kësaj risie ky dokument është me rëndësi për shkak të zbatimit të Reformës në Drejtësi, pasi kjo jo vetëm reformoi sistemin së brendshmi, por synoi një reformim më gjithëpërfshirës duke iu drejtuar edhe qytetarëve. Ndaj, në këtë aspekt, SELP është një produkt i reformës në drejtësi dhe zbatimi i suksesshëm i saj është i lidhur ngushtësisht me këtë reformë.

Në këtë drejtim, nevoja për fuqizimin e edukimit ligjor të publikut, është evidentuar edhe nga Bashkimi Europian (BE) i cili në progres raportin e vitit 2021, rekomandon që për vitin pasardhës, të vijohet me konsolidimin e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë dhe qeverisjes së institucioneve, duke përfshirë fuqizimin e mëtejshëm të edukimit ligjor të publikut ...¹⁴.

12 Ibid., f. 215.

13 Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut, miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr. 47/2019 Për Miratimin Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023,

14 Albania progress report 2021, i aksesuar në Albania Report 2021 (europa.eu).



Edukimi ligjor i publikut në një perspektivë europiane

Nisur nga sfondi i mësipërm, edukimi ligjor i publikut përmbush disa funksione. Së pari, i shërben aftësimin juridik të qytetarëve për të shmangur konfliktet me ligjin apo për t'i zgjidhur këto konflikte gjyqësisht, por duke pasur tashmë kuptim më të mirë të të drejtave dhe detyrimeve dhe mbi të gjitha duke ditur se ku mund të drejtohen për të kërkuar ndihmë. Në këtë mënyrë garantohet qasja në drejtësi e qytetarëve që përbën një nga shtyllat mbi të cilat mbështetet shteti i së drejtës.

Në Bashkimin Europian qasja në drejtësi është një e drejtë themelore e reflektuar në nenin 47 të Kartës për të Drejtat Themelore në Bashkimin Europian në të cilin parashikohet se “Kushdo të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e Bashkimit ka të drejtë për një mjet efektiv përpara një gjykate në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë nen. Kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur e caktuar me ligj. Kushdo duhet të ketë mundësinë për t'u këshilluar, mbrojtur dhe përfaqësuar. Ndihma juridike duhet t'u sigurohet atyre që nuk kanë burimet e mjaftueshme për aq sa kjo ndihmë është e nevojshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi.”¹⁵

Dispozita e mësipërme e Kartës duhet lexuar e kuptuar si garantuese e qasjes në drejtësi jo vetëm para gjykatave për mbrojtjen e së drejtës së çënuar, por në një kuptim më të gjerë të përfshijë edhe qasjen në institucionet e tjera, të BE-së apo dhe të Shteteve Anëtare.¹⁶ Kjo dispozitë, thekson edhe nevojën për ofrimin e ndihmës juridike në funksion të realizimit efektiv të qasjes në drejtësi. Në këtë aspekt, ndërgjegjësimi i publikut dhe aftësimi i tyre juridik i shërben qasjes që ata përfitojnë në drejtësi. Agjencia e të Drejtave Themelore në Bashkimin Europian ka konstatuar se qasja në drejtësi është problematike në disa nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian dhe kjo ka ardhur si rrjedhojë e disa faktorëve, duke përfshirë mungesën e ndërgjegjësimin dhe nivelin të ulët të njohurive që mundësohen për mënyrën e qasjes në drejtësi.¹⁷ Rrjedhimisht, ELP është një instrument për të zgjidhur këtë problematikë të konstatuar.

Përpos parashikimit të Kartës, për të ndihmuar qasjen në drejtësi janë miratuar edhe akte legjislativë dytësore që synojnë ofrimin e ndihmës juridike dhe trajtimin e barabartë të palëve në mosmarrëveshje të një natyre të caktuar¹⁸, por nuk ka akte që drejtpërdrejt rregullojnë edukimin ligjor të publikut, duke qenë kjo një sferë që i është lënë ekskluzivisht shteteve anëtare.

Nën këtë sfond, edhe nisma e vendit tonë për të fuqizuar dhe institucionalizuar ELP i shërben rritjes së qasjes së publikut në drejtësi për të garantuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre kushtetuese dhe ligjore. Ky fuqizim është ngushtësisht i lidhur me themelet e shtetit të së drejtës dhe funksionimin e institucioneve demokratike që janë ndër vlerat themelore të Bashkimit Europian. Njëherësh edhe kritere që i nënshtrohen në mënyrë të vazhdueshme vlerësimit për ecurinë e procesit të integritimit nën grup-kapitujt e parë (e njohur edhe si Cluster 1).

15 Neni 47, Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian. (<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>)

16 <https://fra.europa.eu/en/theme/access-justice>, aksesuar ne datën 21.12.2022

17 <https://fra.europa.eu/en/theme/access-justice>, aksesuar ne datën 21.12.2022.

18 Shih Direktiva e Këshillit 2002/8/EC e 27 janarit 2003 për përmirësimin e qasjes në drejtësi në mosmarrëveshjet ndërkufitare duke përcaktuar rregullat minimale lidhur me ndihmën juridike për këto mosmarrëveshje.

Nga ana tjetër, në kushtet e proceseve të mëdha transformuese është e nevojshme një përgatitje më e madhe e publikut lidhur me përgjegjësitë e reja që shoqërojnë pranimin e vendit tonë në Bashkimin Europian. Kjo kërkesë lidhet kryesisht edhe me faktin se procesi i integritit do të shoqërohet me sfida të reja dhe me miratimin e akteve ligjore në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit. Në këtë drejtim, është e nevojshme që të rritet ndërgjegjësimi i publikut për këto procese dhe detyrimet që i shoqërojnë. Në të vërtetë, nisur nga rëndësia që ka ky proces, ligji nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian” i ka ngarkuar Kuvendit detyrën për të garantuar transparencë dhe informim më të madh të publikut për këto procese dhe detyrimet që mbartin.

Ndonëse nuk ka akte në nivel Europian që diktojnë standardet për ofrimin e edukimit ligjor të publikut, institucionalizimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i tij duhet të vijojë si nevojë për të rritur nivelin e kulturës juridike për qytetarët e cila ndikon ndjeshëm në forcimin e kulturës demokratike dhe shtetin e së drejtës si parakushte për suksesin e procesit të integritit.

2

Kuptimi i Edukimit Ligjor të Publikut

Edukimi ligjor i publikut, ndonëse njihet si një nga format më të hershme të ofrimit të ndihmës ligjore, është një koncept relativisht i ri në rrafshin ndërkombëtar e sigurisht shumë embrional në vendin tonë. Nevoja për edukimin ligjor të publikut u theksua veçanërisht nga Dokumenti Analitik për Reformën në Drejtësi¹⁹, ndonëse manifestime të izoluara të tij të zbatuara në praktikë janë konstatuar edhe më herët. Më vonë, SELP ishte akti i parë që iu kushtua plotësisht edukimit ligjor të publikut, por pa ofruar një përkufizim shterues të edukimit ligjor të publikut. Në fakt, është disi e vështirë për të gjetur një të tillë të gjithëpranuar, duke qenë se ELP është koncept paksa fluid dhe rrjedhimisht i vështirë për t'u përkufizuar, por sigurisht doktrina ka prodhuar disa të tillë që mund të shërbejnë si udhërrëfyes për veprimtarinë e institucioneve të angazhuara në ofrimin e edukimit ligjor të publikut.

Mungesa e një përkufizimi të gjithëpranuar ka bërë që koncepti i ELP të ndeshet shpesh me terma të tjerë si edukimi në drejtësi, fuqizimi ligjor, edukimi ligjor i komunitetit apo edhe aftësimi juridik. Njëherësh edhe fusha e veprimit në ELP është shumë e gjerë duke përfshirë nga informimi bazë mbi të drejtat dhe detyrimet deri tek zgjerimi apo përforsimi i njohurive të mirëfillta juridike.²⁰

Në literaturë ndeshet përkufizimi i Prof. Richard Grimes²¹ i cili përcakton se: ELP siguron për individët ndërgjegje, dije dhe kuptim të të drejtave dhe çështjeve ligjore, bashkë me besimin dhe aftësitë e nevojshme për të zgjidhur konfliktet ligjore dhe të fitojnë qasje në gjykatë...(dhe)... të identifikojnë kur kanë nevojë për mbështetje/ndihmë dhe si mund ta gjejnë atë.²² Në këtë kontekst, është e rëndësishme në një demokraci, që individët jo vetëm t'i njohin të drejtat e tyre, por edhe t'i ushtrojnë efektivisht ato. Individët që i kuptojnë të drejtat dhe detyrimet njëherësh ndikojnë pozitivisht edhe në shoqëri, duke rritur nivelin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së autoriteteve publike.

Nëse përdorim si standard këtë përkufizim, atëherë duhet të bëjmë një dallim mes tij dhe së drejtës për informim. Për hir të së vërtetës, nuk janë koncepte përjashtuese, por kanë nuanca që i dallojnë paksa, ndaj e shohim me vend që të ndalemi në këto diferenca për hir të faktit se ekziston një konfuzion i reflektuar edhe në SELP mes këtyre koncepteve.

Kuptimi i së drejtës së informimit sipas ligjit përkatës, i referohet kryesisht të drejtës së individëve për të kërkuar informacionin publik të mbajtur nga autoriteti publik.²³ Në një kuptim më të gjerë kjo e drejtë përfshin edhe detyrimin për transparencë, si detyrim i autoritetit publik për të bërë publik informacionin, pa kërkesë, për subjektet e interesuara. Ky publikim përfshin një listë të gjatë të informacionit lidhur me strukturën, aspektet financiare, të prokurimeve publike etj., që sigurisht ndikojnë pozitivisht në informimin

19 Dokumenti Analitik i Reformës në Drejtësi, f. 214, e aksesueshme në http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf

20 Lisa Wintersteiger, Legal Needs, Legal Capability and the Role of Public Legal Education, f. 8. Autorja e cituar i referohet konceptit të Edukimit Ligjor dhe Informimit të Publikut.

21 <https://www.law.ed.ac.uk/people/richard-grimes>

22 Richard Grimes, Public Legal Education – The Role of Law Schools In Building A More Legally Literate Society (2021), cituar në Book Review, Amy Wallace, Public Legal Education – The Role of Law Schools In Building Amore Legally Literate Society (Routledge 2021)

23 Neni 3, ligji nr.1119/2014 'Për të drejtën e informimit'

e publikut, por në drejtim të edukimit të tij, luan një rol pasiv. Përpos faktit që është shumë e vështirë për qytetarët²⁴ që të kuptojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre nga tërësia e akteve ligjore e nënligjore të publikuara në faqen e internetit të autoritetit përkatës, ndodh jo rrallë herë që këto akte janë edhe të pa-përditësuara. Ndaj, e drejta për informim, ndonëse në një kuptim të gjerë i shërben edukimit ligjor të publikut, nuk është mirëfilli edukim ligjor i publikut. Ky i fundit, kërkon një qasje më proaktive nga institucionet për të krijuar kulturën juridike përmes njohjes së ligjeve në fushat prioritare dhe me interes për kategori të caktuara si dhe aftësimin e individëve për të zbatuar në praktikë njohuritë e fituara.

Në literaturë, është ravijëzuar një tjetër dallim, mes informimit ligjor dhe edukimit ligjor të publikut. Rasti i parë i referohet kryesisht, rregullave dhe detajeve për situata të caktuara ligjore. Ndërsa në rastin e edukimit ligjor të publikut, ofrohet mekanizmi për të zbatuar informacionin ligjor në një mënyrë të kontekstualizuar.²⁵

Nga ana tjetër, duhet të bëhet dallimi mes kuptimit të ELP si dhe arsimit juridik. Shpesh herë krijohet konfuzion mes tyre, i reflektuar edhe në Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut. Këto janë dy koncepte që i shërbejnë njëra tjetrës, por nuk mund të jenë e njëjta gjë ose edhe të krahasueshme. Arsimi ligjor/juridik është ndjekja e cikleve të studimeve universitare në përfundim të të cilave studenti merr njohuri të thelluara në disiplinat e ndryshme të së drejtës, dhe pajiset me diplomë e cila i shërben për të ushtruar profesionin e juristit drejtpërdrejt apo për të vijuar kualifikimet e mëtejshme në fushën e drejtësisë. Ndërsa, edukimi ligjor i publikut synon njohjen e të drejtave dhe detyrimeve që norma të caktuara ligjore njohin dhe imponojnë ndaj publikut si dhe ushtrimin e tyre në një kontekst të caktuar ligjor.

2.1 Format e Edukimit Ligjor të Publikut

Në gjenezë forma klasike e edukimit ligjor të publikut, ka qenë Street Law, që nënkuptonte daljen e studentëve të drejtësisë jashtë auditorëve për të prezantuar ligjin (ose të drejta dhe detyrime konkrete) për nxënësit e shkollave të mesme.²⁶

Me zhvillimin e vrullshëm të teknologjisë, është bërë e mundur që informacioni të shkojë tek individ, pa qenë e nevojshme për të kontaktuar fizikisht me të. Ndaj, mënyrat e përhapjes së informacionit ligjor për kategori të caktuara, janë të shumëllojshme e nuk mund të themi që një veprimtari është korrekte ose e saktë dhe të tjerat të gabuara. Megjithatë, është e rëndësishme që për secilin grup të shënjestruar të përdoret mënyra më efektive për t'i përçuar tek përfituesit.

Përveç formës klasike të manifestimit të ELP si street law, sot kjo formë edukimi mund të arrihet përmes, aktiviteteve që transmetohen në televizione, radio, broshura informative, mësimdhënies në institucionet e arsimit parauniversitar, fushata për rritjen e ndërgjegjësimit²⁷ etj. Të dhënat tregojnë që metoda të ndryshme të ofrimit të ELP janë efektive për ndjekjen e qëllimeve të caktuara. Për shembull, metodat e shpërndarjes së informacionit ballë përballë i përforcojnë më shumë aftësitë, të prodhojnë vetëbesim dhe të stimulojnë veprimin.²⁸ Materialet online ose të printuara ofrojnë informacion dhe udhëzime për një numër shumë më të madh përdoruesish, por ka të ngjarë të jenë më pak efektive në rritjen e aftësive të përfituesve ose tejkalimin e mungesës së vetëbesimit prej tyre.²⁹

24 Dhe jo vetëm për qytetarët. Ndonjëherë edhe për juristët është e vështirë, veçanërisht kur nuk ekziston një sistemi i mirë i publikimit të akteve në fuqi, pra duke integruar edhe ndryshimet vijuese të ligjeve/akteve.

25 Lisa Wintersteiger, Legal Needs, Legal Capability and the Role of Public Legal Education, f.7.

26 Brandon Golob, Student in the Seats, Teacher in the Streets: Evaluating the Impacts of Law Students Becoming "Street Law" Teachers, f. 38.

27 Lisa Wintersteiger, Legal Needs, Legal Capability and the Role of Public Legal Education, f.10.

28 Developing capable citizens: the role of public legal education. The report of the PLEAS Task Force, korrik 2007, pg. 37

29 Developing capable citizens: the role of public legal education. The report of the PLEAS Task Force, korrik 2007, pg. 37.



2.2 Përfituesit dhe qëllimi i ELP

Në parim përfituesit e ELP janë të gjithë individët pa asnjë përjashtim. Megjithatë, si kategori e identifikueshme që ka nevojë më shumë për të përfituar nga ELP mund të rendisim personat që për arsye të moshës apo gjendjes ekonomike që përgjithësisht ndeshin pengesa për qasjen në drejtësi, si për shembull të moshuarit, të rinjtë, pakicat, përfituesit nga programet sociale të qeverisë etj.

Qëllimi i ELP është jo vetëm të ndërgjegjësojë individët për të drejtat dhe detyrimet e tyre ndaj shtetit apo dhe ndaj të tjerëve, por mbi të gjitha të krijojë kulturën juridike, duke i bërë qytetarët sfidues dhe më kërkues ndaj veprimtarisë shtetërore dhe nga ana tjetër, institucione llogaridhënëse. Ndaj, përfitimet e ELP vijnë jo vetëm në një rrafsh individual, por edhe më gjerë, duke përfituar shoqëria në tërësi nga qytetarë me ndërgjegje juridike që kuptojnë, zbatojnë dhe adresojnë si duhet problemet juridike.



Historiku i lindjes dhe zhvillimit të Edukimit Ligjor të Publikut

ELP ka lindur rreth mesit të shekullit të 20 në Amerikën e Veriut, si një strategji nga lëvizjet për të drejtat civile dhe programet për zbutjen e varfërisë.³⁰ Forma e parë e manifestimit të ELP ka qenë Street Law (SL)³¹. Më konkretisht, në 1972 një grup i vogël studentësh dhe profesorësh nga Universiteti Georgetown pilotuan një formë të klinikës së ligjit në një program për edukimin ligjor të publikut të quajtur Street Law (SL). Qëllimi i programit ishte të edukonin adoleshentët në dy shkolla të mesme publike mbi sistemin ligjor dhe ligjet që kishin ndikim në përditshmërinë e tyre.³² Në 1975 u formalizua krijimi i një organizate kombëtare, Instituti Kombëtar për Edukimin ligjor të Qytetarëve e cila përhapoi lajmin për suksesin e programit të Universitetit Georgetown dhe kërkoi ndihmë për ta shtrirë këtë program në të gjithë vendin.³³ Sot, pranë këtij universiteti vijon sërish i ofruar pa ndërprerë që nga 1972 programi SL.³⁴ Më vonë programet e edukimit ligjor u huazuan edhe nga organizma të tjerë, përveç fakulteteve të drejtësisë, si dhomat e avokatisë dhe organizatat jofitimprurëse. Suksesi i vazhdueshëm i edukimit ligjor të publikut në SH.B.A mbështetet në bashkëpunimin mes qeverisë, fakulteteve të drejtësisë, komunitetit ligjor dhe ofruesve të tjerë të programeve të ELP.³⁵

Programi i hershëm i SL i pilotuar nga Universiteti Georgetown ka krijuar një shumëllojshmëri programesh të tjera të ofruara nga mësues, avokatë, studentë të drejtësisë, gjyqtarë, stafi i institucioneve të drejtësisë, punonjës policie etj.³⁶ Pas suksesit në SHBA, Street Law është shtrirë edhe përtej kontinentit në saj të influencës së organizatës Street Law Inc. e cila ka vijuar misionin e programit të parë të pilotuar në Universitetin Georgetown.³⁷

Sot programet Street Law kanë këto karakteristika:

1. Të mësuarit me qasje praktike mbi: të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrimet ligjore, detyrimet sipas shtetit të së drejtës, të drejtat e njeriut ndërkombëtarisht të njohura si dhe funksionimi i qeverisjes demokratike;
2. Përdorimi i strategjive ndërvepruese për të zhvilluar aftësi të rëndësishme: angazhimi qytetar, advokacia, zgjidhja e problemeve, analiza kritike dhe komunikimi.
3. Përfshirja e komunitetit në procesin e edukimit: ekspertë ligjorë të fushave të caktuara vizitojnë auditorët e bashkë me studentët shkojnë në komunitet për të vëzhguar dhe ndikuar ligjin në veprim.³⁸

30 Lisa Wintersteiger, Legal Needs, Legal Capability and the Role of Public Legal Education, f.8.

31 Street Law është një formë e edukimit ligjor të publikut, e institucionalizuar në shkollat e drejtësisë dhe e administruar tek adoleshentët. (shih Brandon Golob, Student in the Seats, Teacher in the Streets: Evaluating the Impacts of Law Students Becoming "Street Law" Teachers,)

32 Brandon Golob, Student in the Seats, Teacher in the Streets: Evaluating the Impacts of Law Students Becoming "Street Law" Teachers, f. 38.

33 Ibid., f. 38.

34 Law Student FAQ | Georgetown Law

35 Lee Arbetman, Street Law, Inc.: Context, History and Future, fq. 12.

36 Lee Arbetman, Street Law, Inc.: Context, History and Future, fq. 5.

37 Lee Arbetman, Street Law, Inc.: Context, History and Future, fq. 5.

38 Lee Arbetman, Street Law, Inc.: Context, History and Future, fq. 5.



Kuadri i brendshëm rregullues për Edukimin Ligjor të Publikut

Deri me miratimin e SELP nuk kishte akte kushtuar plotësisht ELP, ndonëse rregullime të tij gjenden në mënyrë shumë rastësore në akte të tjera ligjore. Përmendim këtu, Kodin e Procedurave administrative që ka si një parim themelor të tij informimin, por njëherësh një parim tjetër ku mbështetet veprimtaria e organeve publike, është parimi i dhënies së ndihmës aktive, sipas të cilit organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjore në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë që të jetë e mundur.³⁹

Në këtë drejtim, përmendim edhe rolin që ka ligji “Për të drejtën e informimit”, i cili sikurse u analizua më sipër, ndihmon në ELP, por nuk është në vetvete mirëfilli edukim ligjor i publikut e për rrjedhojë nuk përmbush misionin e tij.

Një tjetër akt me rëndësi është Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit” përmban parashikime të posaçme për të miturit të përfshirë në proceset penale me qëllim edukimin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale në të ardhmen.⁴⁰ Përmendim gjithashtu edhe ligjet që kanë rregulluar dhënien e ndihmës juridike falas të cilat kanë bërë një rregullim sipërfaqësor të edukimit ligjor të publikut.

Pavarësisht ekzistencës së këtyre instrumenteve ligjore të cilat në mënyrë shumë të tërthortë trajtojnë aspekte të edukimit ligjor të publikut, ky dokument politikash nuk do të marrë në analizë përmbajtjen e tyre. Përkundrazi, në fokus të saj janë aktet që rregullojnë në mënyrë ekskluzive ELP. Një nga dokumentet më me rëndësi në sferën e ELP është Strategjia e Edukimit Ligjor të Publikut (SELP) dhe Plani i Veprimit (PV) i miratuar. Theksojmë që SELP u hartua si pjesë e paketës së akteve të reformës në drejtësi.

4.1 Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut

Në kushtet e mungesës së institucionalizimit të ELP, dokumenti i SELP ishte i pari dokument që hodhi themelet për ofrimin e edukimit ligjor në mënyrë të qëndrueshme tashmë edhe nën një strukturë mbikëqyrëse e koordinuese dhe një angazhimi më të madh institucional. SELP u miratua me Vendimin e Kuvendit nr. 47, datë 18.4.2019.

Pikësëpari, sikurse u nënvizua edhe pak më sipër, SELP vendos theksin tek e drejta për informim, si një detyrim i përgjithshëm i autoriteteve publike për të ofruar informacion me ose pa kërkesë tek personat e interesuar. Nisur edhe nga analiza e mësipërme mbi kuptimin e ELP, e drejta për informim, sigurisht ndihmon, por nuk është mirëfilli edukim ligjor i publikut, pasi në këtë të fundit kërkohet aktivizim dhe aftësim për ushtrimin e të drejtave që burojnë nga kuadri ligjor për qytetarët. Ndaj, ky dokument thekson se e drejta e informimit përdoret si një instrument për të ushtruar ELP, por në vetvete nuk është e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin që ka ELP për të aftësuar individin që të përdorë në mënyrë të kontekstualizuar njohuritë ligjore për të shmangur apo zgjidhur konfliktet ligjore. Strategjia duhet ta kishte ravijëzuar këtë dallim, për të evidentuar veçantitë që ka ELP në dallim nga e drejta për informim dhe për të mos krijuar konfuzion mes këtyre koncepteve.

³⁹ Neni 10, Kodi i Procedurave Administrative.

⁴⁰ Ligji nr. 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit.

Strategjia e ELP ka katër objektiva strategjike që janë:

1. Përmirësimi i organizimit dhe funksionimit institucional në ofrimin e ELP;
2. Garantimi dhe forcimi i bashkëpunimit efektiv ndërinstitucional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për realizimin e ELP;
3. Sigurimi i performancës efektive dhe efçente të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile;
4. Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.⁴¹

Siç mund të konstatohet, objektivat strategjike të SELP e vënë theksin tek kuadri institucional i përbërë kryesisht nga institucione publike, që dëshmon për vizionin që ka pasur SELP, orientimi i ELP drejt institucioneve publike, të cilat nuk kanë pasur përvojë në ofrimin e edukimit ligjor të publikut.

4.1.1 Struktura Mbikëqyrëse e SELP

Në funksion të arritjes së objektivave strategjike të synuar, SELP ka ngritur një strukturë koordinuese dhe mbikëqyrëse për ELP. Organizimi është shtrirë në dy nivele, në mbikëqyrjen dhe koordinimin nga MD si institucioni i përcaktuar për përgatitjen e draft raporteve pasi mbledh raportimet nga institucionet përkatëse dhe Rrjetit Kombëtar të Edukimit Ligjor të Publikut (Rrjeti) si strukturë që bashkërendon të gjithë institucionet me qëllim ndjekjen e politikës kombëtare për ELP. Rrjeti, funksionon përmes organeve të tij detyrat dhe përgjegjësitë e të cilëve janë rregulluar më me detaje nga Rregullorja e Rrjetit.

a. Rrjeti Kombëtar i Edukimit Ligjor të Publikut

Strategjia i ka ngarkuar Kuvendit detyrën për ngritjen e Rrjetit Kombëtar të ELP. Rrjeti ka një përbërje me bazë të gjerë pasi përfshin përfaqësues të institucioneve kryesore kushtetuese ose të krijuara me ligj (si Presidenti, Kuvendi, Kryeministria, Avokati i Popullit, Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale etj), përfaqësues të 8 ministrive, përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, përfaqësues të AMA-s, të Radiotelevizionit Shqiptar, dhomave të profesioneve të lira si noter, avokatë, ndërmjetës dhe përmbaruesit gjyqësor privatë, përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, shoqatat e Bashkive, Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, 5 (pesë) Organizata të Shoqërisë Civile që punojnë për edukimin ligjor të publikut, Organizata Ndërkombëtare, 2 (dy) fakultete të drejtësisë që kanë klinika ligjore (një publik dhe një privat).⁴²

Funksionet kryesore të rrjetit janë nxitja dhe garantimi i bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet institucioneve publike, institucioneve të arsimit dhe shoqërisë civile me qëllim planifikimin e koordinuar të politikave, monitorimin e zbatimit të tyre dhe bashkëveprimin ndërinstitucional në fushën e edukimit ligjor të publikut.⁴³ Në realizimin e këtyre funksioneve Rrjeti, ndër të tjera, ka edhe këto kompetenca: nxit bashkëpunimin dhe bashkëveprimin midis institucioneve publike, monitoron zbatimin e politikës kombëtare mbi ELP, analizon kuadrin ekzistues ligjor dhe jep rekomandime për përmirësimin e tyre dhe ndjek zbatimin e SELP dhe PV.⁴⁴

b. Komisioni Drejtues i Edukimit Ligjor të Publikut

Organet e Rrjetit janë Komisioni Drejtues i Edukimit Ligjor të Publikut (KDELP) dhe Bordi Këshillimor (BK).⁴⁵

⁴¹ Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut, f. 41-44.

⁴² SELP, f. 46

⁴³ Neni 2, Rregullorja e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut.

⁴⁴ Neni 4, Rregullorja e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut.

⁴⁵ SELP, f. 46



Për shkak të rolit të rëndësishëm që ka Kuvendi, pranë të cilit është ngritur dhe funksionon struktura koordinuese e ELP, kryetari i Komisionit Drejtues është përfaqësuesi i Kuvendit. Në përbërje të KDEL P janë përfaqësuesit e institucioneve vijuese: Kuvendit; Kryeministrisë; Ministrisë përgjegjëse për çështjet e drejtësisë; Ministrisë përgjegjëse për arsimin; Ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme; Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas; Autoritetit të Mediave Audiovizive; Këshillit të Lartë Gjyqësor; 2 (dy) organizatave të shoqërisë civile që punojnë për edukimin ligjor të publikut; 1 (një) fakulteti drejtësie që ka klinikë ligjore.⁴⁶

c. Bordi Këshillimor

Ndërsa Bordi Këshillimor përbëhet nga ekspertë dhe akademikë me përvojë në fushën e ELP, dhe ka rol këshillimor të Komisionit Drejtues në plotësimin dhe përmirësimin e politikave në fushën e edukimit ligjor të publikut.⁴⁷ Anëtarët e Bordit përzgjidhen nga Komisioni Drejtues, midis pedagogëve, ekspertëve dhe akademikëve që kanë shprehur interes, pas shpalljes publike për aplikim të njoftuar në faqen zyrtare të Kuvendit.⁴⁸

Veprimtaria e Rrjetit mbështetet nga Sekretariati Teknik i cili, kryen shërbime ndihmëse, teknike dhe administrative.⁴⁹

4.2 Plani i Veprimit

Plani i veprimit në zbatim të SELP, u hartua nën mbikëqyrjen dhe koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe u miratua në nëntor 2020 nga Këshilli i Ministrave.⁵⁰ Ndonëse strategjia parashikonte një afat 6 mujor për hartimin e PV nga data e miratimit të SELP, procesi mori pak më shumë kohë. PV është ndërtuar në harmoni me objektivat strategjike të SELP dhe identifikon masat konkrete që duhet të marrin anëtarët e rrjetit në drejtim të arritjes së objektivave strategjike.

46 SELP, f. 46.

47 SELP, f. 47.

48 Neni 9, rregullorja e Rrjetit Kombëtar të Edukimit Ligjor të Publikut.

49 Neni 17, Rregullorja e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut.

50 Vendim Nr. 878, Datë 11.11.2020 Për Miratimin e Planit të Veprimit 2020–2023, në Zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor Për Publikun 2019–2023.



Roli i institucioneve kryesore në edukimin ligjor të publikut

5.1 Kuvendi

Kuvendi ka pasur një rol parësor në krijimin e rrjetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të SELP dhe PV, pasi iu ngarkua detyra për ngritjen e Rrjetit dhe për shkak të këtij roli, përfaqësuesi i Kuvendit në Komisionin Drejtues është njëherësh edhe kryetar i KDEL.P. Kuvendi për shkak të natyrës së tij si organi ligjvënës, ka një detyrim të shtuar për ELP. Në përmbushje të këtij misioni, disa nisma domethënëse janë realizuar ku përmendim, miratimin e ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”⁵¹ që përbën një hap të rëndësishëm drejt njohjes së nismave të reja ligjore dhe prezantimin e tyre tek publiku. Së dyti, miratimi i ligjit “Për rolin e Parlamentit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”, ka përcaktuar një standard më të lartë transparence për çështjet Europiane, duke detyruar Kuvendin për të krijuar një rubrikë të veçantë për informimin e publikut për çështjet e integritetit europian në faqen e tij zyrtare në internet.⁵² Dhe së fundi, një masë me natyrë edukuese, është edhe nisma e transmetimit live të seancave të komisioneve që mund të aksesohet në faqen zyrtare web të Kuvendit.

Përpos këtyre nismave, PV i hartuar në zbatim të SELP, ka përcaktuar disa detyra të tjera për Kuvendin në funksion të ofrimit të edukimit ligjor të publikut. Midis të tjerash, Kuvendi duhet të sigurojë një transparencë të shtuar mbi veprimtarinë e edukimit ligjor të publikut, si ngritja dhe përditësimi i faqes web kushtuar Rrjetit përmes: (I) Hedhjes së të dhënave mbi aktivitete që ndërmerren për ELP në fushën e legjislacionit sipas fushës së përgjegjësisë së çdo ministrie (anëtarë të Rrjetit) dhe të autoriteteve të tjera publike dhe publikimi i të gjithë raporteve apo dokumenteve që miratohen nga Rrjeti dhe organet e tij.⁵³

Nga një shqyrtim i detajuar i faqes së Kuvendit rezulton se edukimi ligjor i publikut nuk ka një hapësirë të dukshme dhe kushtuar ekskluzivisht ELP, por informacioni për të gjendet nën rubrikën “Dokumente Strategjike”. Ndërkohë që PV kërkon ngritjen e një faqeje web për Rrjetin e Edukimit Ligjor të Publikut. Edhe nën këtë rubrikë, informacioni i publikuar është jo i plotë, pasi mungojnë raportet e miratuara nga Komisioni Drejtues i ELP. Në datën e aksesuar⁵⁴, në faqe gjenden të publikuara: SELP, PV, Vendimi nr. 1/2019 për Krijimin e Bordit Këshillimit, Raportim i Kuvendit për veprimtarinë e realizuar për ELP, por pa specifikuar periudhën, si dhe procesverbalet e mbledhjeve të realizuara nga Rrjeti në datat 23.11.2020, 23.2.2021, 3.3.2021, 26.5.2021. Në këtë faqe mungojnë vendimet e KDEL.P për miratimin e raporteve të hartuara nga MD për ELP. Për më tepër, që nuk ka informacion për rreth 1 viti e gjysmë mbi veprimtarinë e realizuar nga Rrjeti.

Një tjetër detyrim që buron nga PV është hartimi i planit të komunikimit i cili nuk është publikuar, madje edhe në shkresën nr. Prot. 3760/1, datë 25.11.2022 të Kuvendit si përgjigje e shkresës së KShH-së për të kërkuar informacion⁵⁵, mes të tjerash, edhe për vendosjen në dispozicion të Planit të Komunikimit të hartuar sipas PV, kërkesa nuk është adresuar. Në këto kushte, jemi të prirur të besojmë që përmbushja e këtij detyrimi që buron nga PV nuk është realizuar prej Kuvendit.

51 Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin publik”.

52 Neni 23 (1)(2), Ligji nr. 15/2015 Për rolin e Kuvendit në Procesin e Integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

53 Masa 2.1.2 a, Plani i Veprimit

54 6.12.2022.

55 Nr.Prot.581, datë 11.11.2022



5.2 Ministria e Drejtësisë

Ministrisë së Drejtësisë (MD) me ligj⁵⁶ i është ngarkuar detyra të kujdeset dhe mbështesë veprimtaritë shkencore në fushën e drejtësisë dhe përhapjen e edukatës juridike, si dhe të kujdeset për ndjekjen dhe bashkërendimin e marrëdhënies me shoqërinë civile për fushën e drejtësisë.⁵⁷ Praktikisht, në terma të tjerë, ligji rregullues i veprimtarisë së MD-së e ngarkon këtë të fundit me detyrën për përhapjen e edukatës juridike e cila, duhet kuptuar si edukimi ligjor i publikut, pasi ELP synon pikërisht krijimin e edukatës apo kulturës juridike tek individët. Për më tepër, ligji i ka dhënë MD-së një rol të veçantë në drejtim të të drejtave të të miturve, pasi MD-ja mbështet realizimin e veprimtarive në fushën e drejtësisë për të miturit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga ana e tyre, si dhe për ushtrimin e shërbimeve ndaj të miturve, nga strukturat përkatëse të sistemit të drejtësisë, sipas parashikimeve të ligjeve të posaçme në fushën përkatëse.⁵⁸ Përpos këtij roli të MD-së që buron nga ligji i saj organik, SELP i ka dhënë të tjera përgjegjësi MD-së në drejtim të edukimit ligjor të publikut qoftë si pjesë me rëndësi e strukturës mbikëqyrëse apo përgjegjësi për të avancuar ELP veçanërisht për të miturit.

Ndërsa sipas SELP, MD-ja ka marrë edhe një rol koordinues të monitorimit të zbatimit të saj, pasi shërben si niveli i parë i mbikëqyrjes së veprimtarisë së organeve, pjesë e rrjetit. E konsiderojmë si nivel i parë, pasi mbikëqyrjen përfundimtare të veprimtarisë në kuadër të strategjisë e ka Kuvendi. MD-së gjithashtu iu caktua detyra për hartimin e planit të veprimit. Pas përfundimit të kësaj faze, MD-së iu ngarkuar detyra që të hartojë planet e raportimit të institucioneve pjesë e rrjetit, të cilat i dërgohen Komisionit të Edukimit Ligjor të Publikut për miratim.

Në zbatim të SELP, plani i veprimit ka parashikuar disa detyra konkrete për MD-nw, si për shembull: Krijimi i databazës së donatorëve që mbështesin aktivitete të ELP, hartimi i raportit mbi vlerësimin e nevojave për përmirësime të kuadrit ligjor dhe institucional të ELP. Në funksion të informimit lidhur me realizimin e këtyre dy masave KShH-ja iu drejtua përmes një kërkesë për informacion MD-së⁵⁹, e cila në përgjigjen e kthyer përmes shkresës nr. Prot. 5906/1, datë 24.11.2022, nuk i ka adresuar drejtpërdrejt këto kërkesa. Analiza e kuadrit ligjor dhe institucional që rregullojnë ELP, ka qenë një prej masave në funksion të arritjes së objektivit specifik 1.1., i cili përcakton se “Ky objektiv strategjik parashikohet të arrihet nëpërmjet realizimit të objektivave specifike të mëposhtëm: Përmirësimi i legjislacionit, me qëllim parashikimin e parimeve e formave të ELP dhe përfshirjen e ELP në përgjegjësitë e institucioneve”.⁶⁰

Vlerësojmë se informacioni i kërkuar është i rëndësishëm në vlerësimin e ELP pasi së pari identifikon nevojën për ndërhyrje ligjore në rast se nga funksionimi i Rrjetit janë konstatuar pengesa apo vështirësi dhe së dyti, informacioni mbi databazën e donatorëve është sërish një informacion i rëndësishëm për të planifikuar veprimtari të ardhshme të ELP dhe mbi të gjitha për një përfshirje më të madhe të Organizatave të Shoqërisë Civile pasi një nga sfidat me të cilat ndeshet ELP është financimi i qëndrueshëm.

5.2.1 Roli i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në Edukimin Ligjor të Publikut

Miratimi i ligjit të ri nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” synoi të plotësonte reformimin e sistemit të drejtësisë, përmes garantimit të qasjes në drejtësi për qytetarët në nevojë. Ofrimi i ndihmës juridike parësore është një nga format e edukimit ligjor të publikut, ndonëse ka një fushë veprimi më të ngushtë pasi synon një numër më të vogël individësh (ata që janë në konflikt me ligjin dhe që

56 Ligji nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar.

57 Neni 6 ligji nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar.

58 Neni 6, ligji nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar.

59 Nr.Prot. 582, datë 11.11.2022

60 SELP, fq. 40.

plotësojnë kriteret për përfitimin e ndihmës juridike) si dhe ofron këshillim për një rast konkret. Nga ana tjetër, edukimi ligjor i publikut, synon t`i paraprijë këtij momenti duke përgatitur individin përpara se ai të përballet me një konflikt ligjor, duke e ndërgjegjësuar dhe edukuar atë në mënyrë që të jetë i aftë të përdorë njohuritë e fituara në një kontekst të caktuar rrethanash. Gjithsesi, ndonëse me një fokus më të ngushtë edhe ndihma juridike parësore përbën një nga format se si manifestohet edukimi ligjor i publikut. Për rrjedhojë, ky ligj përbën një hap shumë të rëndësishëm në drejtim të realizimit të ELP, pasi një nga funksionet ligjore të Drejtorisë për Ndhmën Juridike Falas është “bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut”.⁶¹ Ndonëse edhe ligji pararendës “Për ndihmën juridike”, parashikonte edukimin ligjor të publikut si një nga format e ndihmës juridike, nuk parashihte ndonjë detyrim konkret të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike për të ofruar edukimin ligjor të publikut.

Roli i DNJF-së është shumë i rëndësishëm në drejtim të ofrimit të ELP, pasi ka në përbërje të saj stafin e kualifikuar dhe të trajnuar për të ofruar edukim ligjor. Sigurisht, është e pamundur që të gjithë aktivitetin për ELP ta ushtrojë kjo drejtori, prandaj është e nevojshme që ajo të shtrijë bashkëpunimin edhe me klinikat e ligjit të krijuara pranë fakulteteve të drejtësisë, organizatat ndërkombëtare e vendase të angazhuara në ofrimin e ELP.⁶²

Për këto arsye, nga pikëpamja strategjike duhej të ishte menduar një rol më kyç për DNJF në sigurimin e ELP për shkak se është një nga institucionet kryesore që ka detyrë funksionale të saj ofrimin e ELP. Nga ana tjetër, kjo kërkon një qasje më proaktive të DNJF. Ashtu sikurse edhe raportet e mëparshme të hartuara nga KShH kanë rekomanduar, DNJF dhe MD duhet të ndërmarrin fushata ndërgjegjësuëse në nivel kombëtar, nëpërmjet takimit periodik me qytetarët, me institucionet kompetente në nivel vendor, dhe shpërndarjes së materialeve në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për qytetarët. Duke marrë shkas nga situata e konstatuar në terren, KShH sugjeron mbajtjen në konsideratë të realizimit të aktiviteteve informuese kryesisht në qytetet në territorin juridiksional të të cilave nuk operojnë ofrues të shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga ana e shtetit.

5.3 Këshilli i Lartë Gjyqësor

Në SELP KLGJ-së i është caktuar detyrimi për të krijuar dhe vënë në funksionim një portal online, me qëllim ofrimin e informacionit të nevojshëm për qasje në drejtësi, natyrën dhe qëllimin e proceseve gjyqësore, ndihmën juridike, tarifin dhe mjetet alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, ky institucion ka detyrë të marrë masa që publiku dhe palët e interesuara të informohen mbi veprimtarinë e gjykatave.⁶³

Lidhur me punën e KLGJ-së në drejtim të krijimit dhe vënies në funksionim të këtij portali, KSHH iu drejtua me shkresën nr. 583 prot., datë 11.11.2022 për të kërkuar informacion mbi veprimet e KLGJ-së në përmbushje të këtij detyrimi. Në fakt, përgjigja e KLGJ-së⁶⁴ nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkesën mbi portalin e lartpërmendur. Por, pasi iu dërgua për koment drafti i këtij dokumenti politikash nga ana e KShH-së, KLGJ informoi që ky portal është krijuar (gjykata.gov.al).⁶⁵ Në fakt, ky portal përbën një unifikim të të gjitha faqeve zyrtare të gjykatave në vend, përveç Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Rrethit

61 Neni 8(2)(e), ligji nr. 111/2017, “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”.

62 Shih Raport Monitorimi “Njohja E Të Drejtës Për Ndhmë Juridike Të Garantuar Nga Shteti” Të dhëna të grumbulluara gjatë misionëve të monitorimit të realizuara në qytetet Kukës, Himarë dhe Librazhd, Janar 2020, f. 34. [RAPORT-MONITORIMI_-Ndihma-Juridike-Librazhd-Kukes-Himare.pdf \(ahc.org.al\)](#)

63 SELP, f. 24.

64 Nr.Prot. 595, datë 15.11.2022

65 <https://gjykata.gov.al/>



Gjyqësor Tiranë, ku ndërthuren informacioni për profesionistët dhe për qytetarët. Për qytetarët mungon informacioni mbi ndihmën juridike dhe mjetet alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Nuk është e qartë se sa e orientuar drejt edukimit ligjor të publikut ka qenë KLGJ në konceptimin e këtij portali, pasi nga lundrimi në të nuk duket shumë miqësor për qytetarin jo jurist. Ndaj, në rishikimin dhe ndryshimin që mund të pësojë portali si rezultat i zbatimit të hartës së re gjyqësore, mund të përdoret ky portal për të vjelë mendimin e qytetarëve mbi aksesueshmërinë e tij nga individët dhe informacionin që është më i nevojshëm për ta.

Nga ana tjetër, KLGJ informon se ka miratuar Planin e Komunikimit për gjykatat në Republikën e Shqipërisë, që shërben si një pikënisje për mënyrën se si gjykatat i përjasen publikut dhe aktorëve të tjerë gjatë një procesi komunikimi e ndërveprimi. Plani, sipas përgjigjes së KLGJ-së është në fazën e fillimit të zbatimit të tij.⁶⁶

Ky plan është paraprirë nga Plani Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, i miratuar me vendimin nr. 590, datë 26.11.2020, i cili parashikonte përfshirjen e informacionit orientues për qytetarët si qasja në gjykatë për kategori të caktuara, informacion mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti, tarifat gjyqësore, informacion mbi procedurën e paraqitjes së ankimit/rekursit etj.⁶⁷ Pavarësisht ekzistencës së këtij plani dhe parashikimeve për të ofruar informacion për qytetarët, faqet web të gjykatave, me disa përjashtime⁶⁸, momentalisht nuk e përmbushin misionin për edukimin ligjor të publikut.

Në të njëjtën linjë me parashikimet e Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, është hartuar së fundi edhe Plani i komunikimit për Gjykatat që synon publikimin online të grafikës informuese për secilën gjykatë, që përmban shpjegimin mbi kompetencën tokësore, numrin e gjyqtarëve, infrastrukturën, largësinë, etj.; pasurimin e faqeve të internetit me informacione të përmbledhura dhe në një gjuhë të kuptueshme, mbi mënyrën se si mund t'i drejtohen gjykatës për të nisur një proces gjyqësor, qasjen në gjykatë nga kategoritë e veçanta dhe grupet vulnerabël, ndihmën juridike falas, hartimin e materialeve informuese mbi përfitimin e ndihmës juridike falas, hartimi i fletëpalosjeve për ankesat/kërkesat drejtuar gjykatës, hartimi i materialeve për të drejtat e të miturve, etj.⁶⁹ Plani i ri i Komunikimit për Gjykatat duket ambicioz dhe sigurisht që i shërben ELP, por kjo kërkon zbatimin sa më korrekt të tij që të përmbushë misionin për edukim ligjor të publikut.

⁶⁶ Shkresa e KLGJ nr. 5904/1, datë 14.11.2022.

⁶⁷ Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, miratuar me vendimin e KLGJ nr. 590, datë 26.11.2020, KLGJ.

⁶⁸ Këtu mund të përmendim Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Lartë të cilat ofrojnë një informacion të qartë dhe thuajse shterues për publikun. Edhe pse në drejtim të ELP dhe në zbatim të Planit të Komunikimit është e nevojshme që edhe këto faqe të përfshijnë informacion të ri të nevojshëm për të lehtësuar aksesin në drejtësi.

⁶⁹ Plani i Komunikimit për Gjykatat 2022-2024, <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/11/PLANI-I-KOMUNIKIMIT-P%c3%8bR-GJYKATAT-2022-2024.pdf>.



Roli i Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në drejtim të realizimit të ELP

Në vendin tonë OSHC-të kanë dhënë një kontribut domethënës në avancimin e ELP. Për shkak të natyrës së veprimtarisë së tyre dhe një tradite tashmë të krijuar në drejtim të ofrimit të këtij edukimi, OSHC-të janë përfshirë në Rrjetin Kombëtar të Edukimit Ligjor të Publikut. Ndaj, pesë organizata të shoqërisë civile që janë të angazhuara në ofrimin e Edukimit Ligjor të Publikut janë pjesë e Rrjetit Kombëtar të Edukimit Ligjor të Publikut. Kjo përfshirje ndihmon në shkëmbimin e eksperiencave mes këtyre aktorëve që kanë ofruar në mënyrë periodike shërbimin e edukimit ligjor të publikut. Kontributi që OSHC-të kanë dhënë në drejtim të edukimit ligjor të publikut, është njohur edhe nga akte me rëndësi si Strategjia për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, e cila konstaton që edukimi ligjor i publikut është realizuar vetëm me anë të projekteve dhe iniciativave të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në këtë fushë dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë.⁷⁰

Pas miratimit të ligjit të ri “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, organizatat e shoqërisë civile të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë ofrojnë ndihmë juridike parësore. Sikurse theksuam edhe më sipër, edukimi ligjor i publikut mund të realizohet edhe përmes ofrimit të ndihmës juridike parësore. Përfshirja më e madhe e organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e ndihmës juridike parësore (si manifestim edhe i edukimit ligjor të publikut) dhe mbështetja financiare e tyre i shërben shtimit të përvojës për të ofruar ELP në mënyrë të vazhdueshme e të qëndrueshme. Raportimet e DNJF tregojnë që numri i organizatave të shoqërisë civile me të cilat është nënshkruar marrëveshje për ofrimin e ndihmës juridike parësore është në rritje.⁷¹ Për rrjedhojë, kjo rritje shërben si një tregues për ekspertizën e fituar nga këto organizata edhe ofrimin e ELP cilësor. Megjithatë, theksojmë se puna që duhet të bëjnë OSHC-të në drejtim të ELP duhet t’i paraprijë momentit kur individit drejtohet tek DNJF për ndihmë juridike parësore/dytësore. Pra, OSHC-të duhet të shërbejnë për të krijuar një qytetar të edukuar juridikisht dhe mbi të gjitha të aftë për të shmangur konfliktin me ligjin e në rast pamundësie për të ditur saktësisht ndihmën që kërkon dhe se si të orientohet. Në këtë drejtim, puna paraprake që bëjnë OSHC-të për ELP ka një fokus më të gjerë, ndërsa ofrimi i ndihmës juridike prej tyre apo DNJF synon orientimin apo dhënien e përgjigjeve ndaj një rasti konkret.

Aktualisht, në vendin tonë veprimtaritë në kuadër të ELP janë të fragmentuara dhe mbi të gjitha nuk ndjekin programe konkrete të hartuara nën mbikëqyrje akademike/profesionale. Ofrimi i ELP është një sipërmarrje e vështirë, ndaj duhet të ndërtohet e funksionojë në drejtim të shkëmbimit të aseteve të secilit pjesëmarrës, veçanërisht mes botës akademike dhe organizatave të shoqërisë civile, ku akademia kontribuon duke dhënë ekspertizën për të zbërthyer në një gjuhë të thjeshtë terminologjinë e ndërlikuar dhe teknike të ligjit, ndërsa nga ana tjetër, OSHC-të ofrojnë eksperiencën e fituar ndër vite në terren për edukimin ligjor të publikut. Ndaj, në këtë perspektivë, përfshirja e OSHC-ve në rrjetin e edukimit ligjor të publikut është një hap shumë pozitiv për hedhjen e themeleve në përbushjen e një misioni që del jashtë kufijve të detyrimit të ngushtë shtetëror.

⁷⁰ Strategjia në Reformën e Sistemit të Drejtësisë, f.28.

⁷¹ Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Analiza Vjetore e Performancës 2021, f. 52-53. <https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/Raporti-vjetor-per-vitin-2021-converted.pdf>



Në këtë linjë, edhe raportet të mëhershme të KShH-së, të hartuara në mënyrë të pavarur, kanë evidentuar nevojën për një përfshirje më të madhe të OSHC-ve për shkak të eksperiencës që ofrojnë në krijimin e politikave të përshtatshme për ofrimin e ndihmës juridike të orientuar sipas nevojave dhe fushave specifike që qytetarët kanë nevojë.⁷²

72 Raport i Ndërmjetëm Monitorimi "Mbi Ngritjen dhe Funkcionimin e Aktorëve Përgjegjës të Ofrimit të Ndihmës Juridike Parësore", Maj 2020, f. 20, [Mbi-ngritjen-dhe-funksionimin-e-aktorëve-përgjegjës-të-ofrimit-të-ndihmës-juridike-parësore.pdf](#) (ahc.org.al)



Modelet më të mira të zbatimit të suksesshëm të edukimit ligjor të publikut

Ndonëse ELP është i rëndësishëm për forcimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, nuk ka tërhequr shumë vëmendje akademike e rrjedhimisht nuk ka trajtesa me qasje teorike të krahasueshme me komponentët e tjerë të lidhur me konceptin e shtetit të së drejtës. Kjo mungesë ka qenë dhe një nga kufizimet e punës kërkimore në realizimin e këtij dokumenti politikash. Rrjedhimisht, për të vjelë modelet më të mira të ELP, i jemi referuar dy vendeve që përfaqësojnë sot standardin më të mirë të ofrimit të edukimit ligjor të publikut.

Së pari, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë vendi ku u hodh dhe u zbatua për herë të parë ideja për edukimin ligjor të publikut, përmes metodës tradicionale të ofrimit të këtij edukimi që është Street Law. Sipas këtij modeli, ELP lindi nga auditorët e Universitetit Georgetown dhe vijoi me tej nga Street Law Inc., një organizatë jofitimprurëse që ishte një zgjatim i programit SL.⁷³ Më vonë këto programe u vijuan edhe nga dhomat e avokatisë, fakultete të tjera si dhe organizatat jo fitimprurëse. Suksesi dhe qëndrueshmëria e këtyre programeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës lidhet kryesisht me frymën e bashkëpunimit efektiv të fakulteteve të drejtësisë, qeverisë, praktikienëve të së drejtës, dhe grupeve komunitare (organizatave jofitimprurëse).⁷⁴

Së dyti, modeli tjetër i ofrimit të ELP vjen nga Mbretëria e Bashkuar. Edhe në këtë vend, ELP ka pasur sfidat e tij, por është punuar për të implementuar një model të përshtatshëm. Në të vërtetë, ELP ka një natyrë shumëformëshe dhe është pak i vështirë për t'u administruar, pasi kërkon staf të kualifikuar për të zbrërthyer konceptet e vështira të ligjit e për t'i përcjellë të një audiencë që nuk ka formim juridik. Këtu, një koalicion i gjerë u krijua në 2006 që identifikoi disa rekomandime mbi mënyrën se si duhet të administrohet ELP. Aktualisht, ELP ofrohet si nga Universitetet⁷⁵ ashtu edhe nga organizata jofitimprurëse, ku përmendim fondacionin LawforLife.⁷⁶

73 Lee Arbetman, Street Law, Inc.: Context, History and Future,

74 Lee Arbetman, Street Law, Inc.: Context, History and Future, f. 12.

75 Shih p.sh.: <https://www.sussex.ac.uk/law/clinical-legal-education/>

76 <https://www.advicenow.org.uk/lawforlife/who-we-are-0>

8

Sfidat e Edukimit Ligjor të Publikut në Shqipëri

Përgjithësisht ELP është një veprimtari sfiduese, ndaj pritshmëria është që edhe në vendin tonë ofrimi i ELP të përballet me sfida. Megjithatë, duhet vlerësuar angazhimi institucional për të mbështetur ELP dhe hartimi i dokumenteve strategjike që përbëjnë hapa cilësor drejt ofrimit të ELP në mënyrë të qëndrueshme e të koordinuar.

Një nga sfidat me të cilat përballet ELP, është gjetja e një përkufizimi mbi të cilin të mbështetet veprimtaria e ofruesve të ELP duke ofruar qartësi se cili veprim do të përkufizohet si edukim ligjor i publikut e cili jo.

Së dyti, është fragmentizimi i tij dhe mungesa e koordinimit të ofruesve të shërbimit të ELP. Siç rezulton edhe nga raportimet që kryejnë institucionet për veprimtarinë në funksion të ELP, nuk ka një harmonizim të mirë të veprimtarive mes tyre, por secili institucion vepron i izoluar nga të tjerët në disa veprimtari (madje një pjesë e mirë e tyre nuk përfshihen në definicionin mbi të cilin ky dokument mbështetet për ELP).

Së treti, një nga sfidat më të mëdha është krijimi i strukturave funksionale që nxisin bashkëpunimin mes aktorëve me eksperiencë në ELP dhe financimi i qëndrueshëm.

Nga përvojat më të mira për edukimin ligjor të publikut rezulton se në qendër të ELP, nuk janë ekskluzivisht institucionet publike. Sigurisht, shteti ka rolin e tij nxitës dhe mbështetës për të gjithë veprimtarinë e ELP, por është një barrë shumë e madhe ofrimi i ELP ekskluzivisht nga institucionet publike. Ndaj, nisur nga përvojat e vendeve nga ku ELP ka lindur dhe është zhvilluar duhet që vëmendja të përqendrohet tek aktorët që mund të japin një kontribut më të madh. Ndër këta aktorë përmendim, fakultetet e drejtësisë, pasi këta kanë shërbyer si vendi i lindjes dhe zbatimit në praktikë të idesë për të aftësuar nga pikëpamja juridike qytetarin. Përkundër këtij roli tradicional, duket se Strategjia dhe PV i kanë kushtuar një hapësirë marginale fakulteteve të drejtësisë në këtë drejtim. Ishte vizioni i profesorëve të Universitetit të Gerogetown ai që nxori në rrugë studentët pasi qytetarët e zakonshëm, jo juristë, kishin nevojë për të kuptuar ligjin në praktikë në mënyrë që të merrnin përsipër përgjegjësitë civile.⁷⁷ Ky është një funksion i cili për shkak të mënyrës se si janë organizuar e funksionojnë fakultetet e drejtësisë, mund të përmbushet me sukses. Kjo kërkon fonde të mjaftueshme, angazhimin e profesorëve të cilët duhet të kenë vizionin dhe idetë e ofrimit të këtij edukimi klinik tek publiku. Njëherësh me eksperiencën e trupës pedagogjike, fakultetet e drejtësisë sjellin zellin dhe pasionin e studentëve që janë në proces diplomimi për të vënë njohuritë e tyre në shërbim të shoqërisë. Kombinimi i këtyre faktorëve mund të jetë një recetë e suksesshme në drejtim të ofrimit të edukimit ligjor tek qytetarët pasi është një veprimtari me përfitim të dyfishtë, për qytetarët dhe për studentët të cilët zbatojnë në praktikë njohuri abstrakte të përfituara nga auditorët.

Angazhimi i të rinjve në drejtim të edukimit ligjor të publikut ka qenë një sugjerim që KShH e ka sjellë edhe më herët, ndonëse me fokus pak më të ngushtë. Në raportin e monitorimit për njohjen e së drejtës për ndihmë juridike të garantuar nga shteti është sugjeruar përfshirja e të rinjve në aktivitete ndërgjegjëse me fokus edukimin ligjor mbi ndihmën juridike të garantuar nga ana e shtetit, si dhe marrja e masave konkrete

⁷⁷ Lee Arbetman, Street Law, Inc.: Context, History and Future, f.1. Edhe në Mbretërinë e Bashkuar, ndonëse i zbatuar më vonë se në USA, nisma për ELP ka ardhur nga Prof. Richard Grimes i cili prezantoi Street Law në 1997 në Universitetin e Derby-t. (Review: Public Legal Education – The Role of Law Schools In Building A more Legally literate Society (Routledge 2021) Amy L. Wallace)

SFIDAT E EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT NË SHQIPËRI

për afishimin e materialeve promovuese të hartuara nga ana DNJF-së në ambientet e institucioneve në nivel vendor, pranë të cilave aksesit i qytetarëve është i shtuar.⁷⁸

Ritheksojmë se roli i akademisë në ofrimin e ELP është me rëndësi pasi programet e ofrimit të edukimit ligjor të publikut duhet të kenë një mbikëqyrje nga komuniteti akademik në mënyrë që informacioni të përcillet me profesionalizëm, saktësi dhe cilësi tek qytetarët. Nga ana tjetër, është po ashtu thelbësore që kjo veprimtari të jetë e qëndrueshme dhe jo sporadike. Ndaj është e nevojshme që të kombinohen kontributet e secilit pjesëmarrës për të krijuar mekanizëm funksional. Ky mekanizëm mund të kombinojë OSHC-të (që edukojnë nga pikëpamja ligjore individin përmes projekteve të shërbimit komunitar) dhe grupe të tjerë të lidhura më ngushtë me arsimin juridik (siç është Dhoma Kombëtare e Avokatisë) të cilat kanë fituar eksperiencën e nevojshme për të ushtruar këtë veprimtari, me fakultetet e drejtësisë që ofrojnë mbikëqyrjen akademike dhe burimet e mjaftueshme njerëzore për të pasur një shtrirje të gjerë të këtij aktiviteti.

Pra, sfida aktualisht është si të ridimensionohet roli i OSHC-ve dhe fakulteteve të drejtësisë në Rrjet duke krijuar më shumë hapësirë për ta zhvilluar më tej ELP.

78 Raport Monitorimi "Njohja E Të Drejtës Për Ndihmë Juridike Të Garantuar Nga Shteti" Të dhëna të grumbulluara gjatë misioneve të monitorimit të realizuara në qytetet Kukës, Himarë dhe Librazhd, Janar 2020, RAPORT-MONITORIMI_Ndihma-Juridike-Librazhd-Kukes-Himare.pdf (ahc.org.al)

9

Gjetjet dhe Rekomandime

Në përfundim, si rezultat i analizës së mësipërme, e gjejmë me vend të theksojmë se diskutimi dhe sjellja e konceptit të edukimit ligjor të publikut në vëmendjen shtetërore është një hap shumë i rëndësishëm në drejtim të ofrimit të tij. Si përgjigje e këtij diskutimi janë miratuar dy dokumente që përbëjnë aktet e para me objekt rregullimin ekskluziv të edukimit ligjor të publikut në Shqipëri. Rrjedhimisht, gjetjet vijuese synojnë përmirësimin e dokumenteve pasuese që do të rregullojnë aspekte të edukimit ligjor të publikut.

Ndonëse janë bërë hapa domethënës duke miratuar akte të rëndësishme si SELP dhe PV, konstatojmë që të dyja aktet nuk kanë ende vizionin e duhur për të ofruar edukim cilësor të publikut. Nga ana tjetër, nga pikëpamja teknike konstatohet herë-herë pasaktësi dhe konfuzion mbi konceptin e ELP. Duke pasur paqartësi mbi përkufizimin e ELP, strategjisë i mungon identiteti koherent dhe identifikimi i praktikave më të mira në ofrimin e edukimit ligjor të publikut.

Gjithashtu, nënvizojmë se duke qenë një akt i miratuar për herë të parë e mbi të gjitha pa ndonjë referencë në ndonjë model konkret funksional, por një krijesë tërësisht vendase, do të ishte e domosdoshme që Strategjia të ishte paraprirë nga një studim i mirëfilltë që të prodhonte të dhëna empirike për nevojat për edukim ligjor si dhe grupet e shënjestruara dhe metodat më efektive në ofrimin e edukimit ligjor cilësor.

Strategjia është voluminoze dhe ka identifikuar një numër institucionesh si pjesë të Rrjetit për Edukimin Ligjor të Publikut, por ka hasur vështirësi për t'u zbatuar në praktikë, edhe për shkak të konfuzionit që e shoqëron si pasojë e mungesës së një përkufizimi funksional për ELP. Siç kemi konstatuar edhe në brendësi të analizës, është bërë referencë tek e drejta e informimit dhe e drejta për arsim, ndërkohë që sikurse është diskutuar edhe më lart, këto të drejta nuk janë koncepte identike, ndonëse ndihmojnë në ofrimin e ELP cilësor. Referimi tek këto të drejta bëjnë që Strategjia të humbasë identitetin e saj si akt që rregullon ELP.

Paqartësia që shoqëron dokumentin strategjik pasqyrohet edhe në draft-progres raportet e përgatitura nga MD (mbi realizimin e masave të PV) që nxisin institucionet publike për saktësi, përmirësim të performancës, respektimin e afateve të raportimit pranë MD.⁷⁹ Madje, një pjesë e aktiviteteve që referojnë institucionet si veprimtari të kryer në kuadër të ELP, nuk janë të tilla e këtu mund të përmendim: pjesëmarrja e stafit të institucionit përkatës në trajnime mbi tematika të lidhura me fushën e veprimtarisë së institucionit, trajnimet e stafit të administratës publike për fusha të caktuara të së drejtës, veprimtaritë për fuqizimin dhe aftësimin e strukturave të institucionit për ushtrimin e kompetencave sipas ligjit, rekomandimet dhe opinionet ligjore të dhëna nga institucione të caktuara, ose thjesht publikimi i listës së ligjeve të zbatueshme për veprimtarinë e një institucioni, e të ngjashme si këto. Konfuzioni në raportim dhe në kuptim të ELP nga institucionet shtetërore nuk i shërben ofrimit të ELP cilësor.

Raportime për realizimin e masave sipas planit të veprimit duken më shumë si përmbushje apo realizime sasiore sesa cilësore.⁸⁰ Për këtë arsye, edhe rekomandimet e MD-së theksojnë nevojën për performancë më të mirë të institucioneve raportuese për zbatimin e masave të caktuara sipas PV, duke qenë se ka pasur problematika me cilësinë e raportimeve dhe respektimin e kohës së raportimit.⁸¹

79 Draft-Raporti i Monitorimit Për Periudhën Janar-Dhjetor 2020, f. 55-56. (Sqarojmë se në faqen e MD janë gjetur draftet e raporteve, pasi këto drafte miratohen nga Komisioni Drejtues i Edukimit Ligjor të Publikut. Raportet përfundimtare të miratuara nga KDELNP nuk gjenden në faqen web të Kuvendit)

80 Draft-Raporti i Monitorimit Për Periudhën Janar-Dhjetor 2020, f. 55-56.

81 Shih, Draft-Raporti i Monitorimit Për Periudhën Janar-Dhjetor 2020, f. 55-56. Njërësh shih edhe draft-Raportin e Monitorimit për Peri-

Në aspektin e mekanizmave të zgjedhur për të arritur objektivat, gjejmë me vend të theksojmë se nisja e veprimtarisë së Rrjetit duhet të ishte paraprirë nga studime që të identifikonin nevojën prioritare për ndërhyrje, të kishte të dhëna empirike mbi njohuritë e qytetarëve mbi të drejtat e tyre dhe nevojat konkrete që kanë grupe të caktuara. Mbi të gjitha këto të dhëna do të ndihmonin në identifikimin e mekanizmit që më mirë arrin objektivin e synuar.

Struktura institucionale e zgjedhur për zbatimin e SELP nuk është shumë e përshtatshme për arritjen e objektivave të synuar. Nisur nga eksperiencia e vendeve me modele të mira të ELP, konstatojmë që edukimi ligjor i publikut arrihet më mirë nëse ka mbështetje financiare shtetërore dhe politika të koordinuara. Ndonëse duhet theksuar se nuk do të ishte realist parashikimi që institucionet publike mund ta ofrojnë plotësisht ELP.

Për këtë arsye, duhet rishikuar struktura dhe funksionet që Rrjeti dhe organet e tij kanë për ELP. Në vlerësimin tonë kjo strukturë ka një përbërje inverse, ndërkohë që pjesën më të madhe të anëtarëve të Rrjetit duhet ta kishin përfaqësues nga fakultetet e drejtësisë dhe organizata të shoqërisë civile, në fakt e kanë institucionet publike e të pavarura, që siç rezulton nga raportimet po ndeshin vështirësi. Në kushtet kur numri i organizatave që ofrojnë ndihmë juridike parësore është rritur është më e lehtë përfshirja e një rrethi më të gjerë organizatash në këtë strukturë.

Gjithashtu në përfundim të analizës së veprimtarisë së institucioneve me një peshë më të madhe në drejtim të ofrimit të edukimit ligjor të publikut, konstatohet se ka një mungesë aktivizimi nga ana e tyre pas mesit të vitit 2021. Faqja e Kuvendit nuk është përditësuar lidhur me veprimtaritë e realizuara nga organet e Rrjetit pas Majit të vitit 2021.

Në drejtim të edukimit ligjor të publikut, një nismë me rëndësi ka qenë miratimi i ligjit të ri “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili i ka ngarkuar DNJF, mes të tjerash, detyrën për edukimin ligjor të publikut. Ndaj, një vëmendje më e madhe dhe një model më përfshirës i DNJF në strukturat e Rrjetit mund të përbënte një model funksional për avancimin e ELP. Sigurisht, që kjo Drejtori do të duhet të bashkërendojë veprimtarinë e saj me një sërë aktorësh veçanërisht me organizatat ndërkombëtare e vendase për të pasur një ndikim më të madh në drejtim të ELP.

Nisur nga problematikat e konstatuara në strukturën aktuale strategjike dhe institucionale, rekomandojmë:

1. Gjetjen e një “përkufizimi” dhe identifikimin e parimeve e praktikave më të mira për edukimin ligjor të publikut. Mungesa e një përkufizimi përbën pengesë në progresin e ELP, kjo pasi nuk arrihet të identifikohet si veprimtari më vetë, të monitorohet dhe të vlerësohet ecuria e tij.
2. Rishikimin e strukturës në kërkim të një modeli më funksional i cili të njohë një rol më të madh për ofruesit tradicionalë të ELP, siç janë fakultetet e drejtësisë, OSHC-të dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas. Në këtë strukturë mund të vlerësohet edhe një pjesëmarrje më aktive e aktorëve të tjerë siç janë dhomat e avokatisë dhe zyrat ligjore për të ofruar ELP sipas fushave të specializimit si veprimtari pro bono.

Gjithashtu, duke vlerësuar rritjen e numrit të OSHC-ve që janë certifikuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, për t'i dhënë një nxitje më të madhe aktivizimit të tyre në strukturat e Rrjetit, mund të vlerësohet përfshirja e tyre me rotacion në organet e krijuara për të pasur një shkëmbim më të madh të eksperiencës së fituar në edukimin ligjor të publikut. Ky rekomandim vjen në një linjë edhe me rekomandimet e mëparshme të raporteve të Komiteti Shqiptar i Helsinkit në kuadër të funksionimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ku është theksuar nevoja për financimin e



menjëhershëm me qëllim rifunksionalitetin e Klinikës së Ligjit pranë FDUT-së (Tiranë).⁸²

3. Duke qenë se ofrimi i ELP ka qenë episodik sugjerohet të raportohet nga ofruesit e ELP puna që kanë realizuar, fusha e përfshirë në programet e tyre, veprimtaritë konkrete të realizuara në funksion të shkëmbimit të eksperiencës, njohurive dhe identifikimit të praktikave më të mira të konstatuara nga ofrimi në terren i këtij edukimi.
4. Mbikëqyrjen profesionale/akademike të programeve të ELP duke synuar saktësinë e informacionit të shpërndarë, qëndrueshmërinë e ofrimit të këtij edukimi dhe adresimin e nevojave konkrete të publikut për edukim ligjor.
5. Një rjetësim i rolit të organeve kryesore, si Kuvendi, MD, KLGJ që kanë një ndikim domethënës në drejtim të ofrimit të ELP për të koordinuar punën mes tyre, si dhe për të frymëzuar krijimin e skemave funksionale për ELP.
6. Kryerjen e studimeve për nxjerrjen e të dhënave empirike lidhur me nivelin e njohurive të publikut dhe nevojave kryesore të tyre për edukim. Këto të dhëna duhet të shërbejnë si bazë për hartimin e strategjisë vijuese.
7. Përdorimi më i gjerë i metodave alternative të ELP, veçanërisht hartimi, printimi dhe shpërndarja e broshurave, libërthave, manualeve të hartuara nga fakultetet e drejtësisë dhe që shpërndahen në zonat që nuk mund të arrihen lehtësisht nga vizitat e studentëve. Mbi të gjitha, përdorimi i një metode të caktuar të shpërndarjes së ELP në varësi të asaj që synohet të arrihet. Pasi metoda të ndryshme të ofrimit të ELP mund të jenë efektive në realizimin e objektivave të ndryshëm dhe janë të përshtatshme për grupe të caktuara.
8. Institucionet publike, në funksion të edukimit ligjor të publikut, të krijojnë në faqet e tyre zyrtare rubrikën e pyetjeve dhe e përgjigjeve (Q&A), ku sipas fushës së kompetencave secili institucion të shpjegojë ligjin e zbatuar në situata të caktuara faktike dhe të adresojë situatat më të shpeshta me të cilat individët ndeshen zakonisht. Kjo veprimtari duhet të jetë e mbikëqyrrur dhe informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar vazhdimisht.

⁸² Raport " Monitorimi i Zbatimit të Ligjit Për Ndihmën Juridike Të Garantuar Nga Shteti, Në Kuadër të Ofrimit të Ndihmës Juridike Parësore ", Nëntor 2019, f. 19, Raport-Ndihma-Juridike-per-publikim-_-Komiteti-Shqiptar-i-Helsinki.pdf (ahc.org.al).

BIBLIOGRAFIA

ARTIKUJ

Abiodun Michael Olatokun, The Journey To Legal Capability: Challenges for Public Laë from Public Legal Education. <https://www.northumbriajournals.co.uk/index.php/ijple/article/view/1294>

Lisa Wintersteiger, Legal Needs, Legal Capability and the Role of Public Legal Education. <https://www.laëforlife.org.uk/wp-content/uploads/Legal-needs-Legal-capability-and-the-role-of-Public-Legal-Education.pdf>

Amy Wallace, Public Legal Education – The Role of Laë Schools in Building a more Legally Literate Society, Book Review, (Routledge 2021). https://digitalcommons.nyls.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=2447&context=fac_articles_chapters

Brandon Golob, Student in the Seats, Teacher in the Streets: Evaluating the Impacts of Law Students Becoming “Street Law” Teachers. <https://www.northumbriajournals.co.uk/index.php/ijple/article/view/1116>

Lee Arbetman, Street Law, Inc.: Context, History and Future. <https://www.northumbriajournals.co.uk/index.php/ijple/article/view/705>

RAPORTE/DOKUMENTE/ANALIZA

Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, <http://www.reformanedrejttesi.al/dokumenti-strategjik-dhe-plani-i-veprimit>

Dokumenti Analitik i Reformës në Drejtësi, e aksesueshme në http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf

Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, miratuar me vendimin e KLGJ nr. 590, datë 26.11.2020, KLGJ.

Plani i Komunikimit për Gjykatat 2022-2024, <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/11/PLANI-I-KOMUNIKIMIT-P%3c3%8bR-GJYKATAT-2022-2024.pdf>.

Albania Progress Report 2021, i aksesuar në Albania Report 2021 (europa.eu).

Raporti i Monitorimit Për Periudhën Janar-Dhjetor 2020 (Ministria e Drejtësisë).

Developing capable citizens: the role of public legal education. The report of the PLEAS Task Force, korrik 2007.

Ministria e Drejtësisë, Darft-Raporti i Monitorimit Për Periudhën Janar-Dhjetor 2020.

Ministria e Drejtësisë, Draft-Raportin e Monitorimit për Periudhën Janar-Dhjetor 2021.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Analiza Vjetore e Performancës 2021.

KShH, Raport Monitorimi “Njohja e të Drejtës për Ndhmë Juridike të Garantuar nga Shteti”. Të dhëna të grumbulluara gjatë misionëve të monitorimit të realizuara në qytetet Kukës, Himarë dhe Librazhd, Janar 2020, RAPORT-MONITORIMI_-Ndihma-Juridike-Librazhd-Kukes-Himare.pdf (ahc.org.al).

KShH, Raport i Ndërmjetëm Monitorimi “Mbi Ngritjen dhe Funksionimin e Aktorëve Përgjegjës të Ofrimit të Ndhmës Juridike Parësore”, Maj 2020, Mbi-ngritjen-dhe-funksionimin-e-aktorëve-përgjegjës-të-ofrimit-të-ndihmës-juridike-parësore.pdf (ahc.org.al)

KShH, Raport “Monitorimi i Zbatimit të Ligjit Për Ndhmën Juridike Të Garantuar Nga Shteti, Në Kuadër të Ofrimit të Ndhmës Juridike Parësore”, Nëntor 2019, Raport-Ndihma-Juridike-per-publikim_-Komiteti-Shqiptar-i-Helsinki.pdf (ahc.org.al)



LIGJE

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.

Ligji nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”.

Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën Juridike të garantuar nga shteti”.

Ligji Nr.10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”.

Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin publik”.

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut, miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr. 47/2019 Për Miratimin Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023.

Rregullorja e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut

Vendim Nr. 878, Datë 11.11.2020 Për Miratimin E Planit të Veprimit 2020–2023, në Zbatim të Strategjisë të Edukimit Ligjor Për Publikun 2019–2023.

Karta për të Drejtat Themelore në Bashkimin Europian, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>

Direktiva e Këshillit 2002/8/EC e 27 janarit 2003 për përmirësimin e qasjes në drejtësi në mosmarrëveshjet ndërkuftare duke përcaktuar rregullat minimale lidhur me ndihmën juridike për këto mosmarrëveshje.

FAQE INTERNETI

Law Student FAQ | Georgetown Law

<https://www.advicenow.org.uk/lawforlife/who-we-are-0>

<https://www.sussex.ac.uk/law/clinical-legal-education/>

<https://fra.europa.eu/en/theme/access-justice>

